

Emine HAJDARI

**PRERJA E MONEDHAVE TË PALIGJSHME NË DARDANI -
RASTI I KALLËPIT NGA MUNICIPIUM ULPIANA**

Abstrakt:

Në këtë artikull trajtohet konteksti arkeologjik e historik i falsifikimit të monedhave, marrë për bazë kallëpin nga Ulpiana, i përdorur për prodhimin e emetimin e monedhave të paligjshme të kohës së Mark Aurelit. Gjatë gërmimeve arkeologjike të zhvilluara në vitin 1957, në lokalitetin e Ulpianës ishte zbuluar një kallëp nga materiali i plumbit, i cili sot ruhet në Muzeun Kombëtar të Kosovës. Ky kallëp ka shërbyer për prodhimin e monedhave gjatë kohës së perandorit Mark Aurel. Në faqen e tij lexohet legjenda AVRELIUS CAESAR AVG. P. II F dhe përfaqëson një monedhë, në anën e pasme të së cilës, me shumë gjasë, ishte legjenda TR POT III COS II. Seritë që prezantojnë këto lloj të monedhave, emetoheshin dhe lëshoheshin ekskluzivisht nga punishtet e Romës, duke sugjeruar kështu se ky kallëp nuk shërbente për prerje monetare zyrtare. Si i tillë ai duhet të jetë përdorur për të prodhuar emesione të falsifikuara. Ulpiana duke qenë qendër e rëndësishme metalurgjike e vendosur në një rajon të pasur me minerale të shumta, sidomos me ari dhe argjend, ka krijuar një ambient të përshtatshëm për adulteratores monetae për të realizuar emetime të paligjshme. Ata ishin shumë aktivë në provincën e Mezisë Superiore si dhe në provinca të tjera fqinje gjatë gjithë shekulli II. Falsifikonin kryesisht denarë për faktin se kjo monedhë ishte me vlerë të konsiderueshme dhe përdorej shumë në tregjet romake. Kallëpi i zbuluar në Ulpianë nuk ishte një kallëp i zakonshëm, por ai me shumë gjasë shërbente më shumë si një matricë në një fazë të ndërmjetme të përgatitjes së kallëpeve për falsifikim të këtyre monedhave.

Fjalë kyçe: *Dardania, Prerje ilegale e monedhave, Ulpiana, Marcus Aurelius, Kallëp, Qendër metalurgjike.*

Vendbanimi i Ulpianës i përmendur në burimet antike të kohës dhe i dëshmuar nga gjetjet arkeologjike, falë pozitës së favorshme gjeografike që posedonte, si dhe pasurive të shumta që zotëronte, para së gjithash atyre minerale, arriti të bëhet njëra nga qendrat më të rëndësishme të prodhimit dhe tregtimit për rajonin. Rëndësia e madhe ekonomike e bëri atë shumë atraktive dhe një qendër gravituese duke bërë që fatin e tyre me të ta lidhin shumë qytetarë nga shumë provinca romake, para së gjithash në sferën ekonomike, madje edhe anëtarë të familjeve të njohura senatoriale, siç e kemi rastin e familjes *Furi* dhe *Ponti*. Nga ana tjetër, metalet që nxirreshin në minierat rreth e përqark saj, si qendra kryesore e *metalla dardanici*, ishin një burim i rëndësishëm për ruajtjen e stabilitetit monetar romak. Një dëshmi e rëndësishme së minierave dardane për ekonominë romake, paraqet edhe zbulimi i lingotave të plumbit me mbishkrimin *dardanici* në Cezare të Izraelit.¹

Epiteti *splendidissima*, një nga epitete më të rëndësishme me të cilat u njoh Ulpiana, mund të justifikohet jo vetëm nga monumentet e shumta arkeologjike, por edhe numri i madh i materialit të lëvizshëm arkeologjik, në mesin e të cilit edhe një numër i madh i monedhave përmes të cilave dëshmohet rëndësia, madhështia dhe fuqia ekonomike e Ulpianës përgjatë gjithë ekzistencës së saj.

Në koleksionin numizmatik të Muzeut Kombëtar të Kosovës, ruhen një numër i madh i monedhave të zbuluara në Ulpianë, qoftë përmes gërmimeve arkeologjike apo të zbuluara si gjetje rasti gjatë punimeve bujqësore. Referuar këtij koleksioni, sasia më e madhe e monedhave të zbuluara në Ulpianë u takon shekujt II-IV pas Kr., gjë që pasqyron një rritje të standardit të jetesës dhe lulëzimin që kishte njohur qyteti gjatë kësaj periudhe. Gjatë shekujve V-VI pas Kr., në Ulpianë ka pasur një rënie të dukshme të qarkullimit monetar, gjë që mund të shpjegohet me periudhën e trazirave për shkak të sulmeve barbare dhe pasojave që lanë ato. Gjatë kësaj periudhe është i habitshëm rrallimi shumë i madh i monedhave të perandorit Justinian, një fakt ky i pashpjegueshëm kur dihet se ai ndërmori një fushatë

¹ Slobodan Dušanić, "Propskografske beleške o rudarstvu u Gornjoj Meziji", *Starinar* LVI, 2006, 87

të gjerë ndërtimesh në Ulpianë, fushatë kjo e cila duhej të kishte ringjallur aktivitetet ekonomike në rajon.²

Sa i përket shtrirjes kronologjike, monedhat e gjetura në Ulpianë, datohen që nga shekulli I para Kr., (Mark Antonit) deri në fund të shekullit VI pas Kr., (Justini II). Ato u përkasin disa perandorëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre dhe janë prerë në provincat lindore dhe perëndimore dhe vinë kryesisht nga qendrat, si: Roma, Kartagjena, Antiokia, Aleksandria, Lugdunum, Aquileia, Ticinum, Siscia, Pautalia, Serdica, Nikomedia, Cyzicus, Selaniku, Heraklea, Kostandinopoja. Përveç kësaj, ka edhe prodhime lokale, që vinë nga punishtet vendore si nga Vimicianumi, Stobi, Sirmiumi dhe Heraclea.³

Përkundër rëndësisë së madhe ekonomike, tregtare dhe metalurgjike që kishte Ulpiana gjatë gjithë antikitetit, nuk është dëshmuar që ajo kishte të drejtën e emetimit të monedhave siç e kemi rastin me qendrat e tjera lokale siç ishin: Viminaciumi, Stobi apo Hereclea. Në anën tjetër lidhja e prerjeve lokale *Metalla Ulpiana* me Ulpianën, në mungesë të gjetjeve arkeologjike, nuk është e mundur.⁴ Megjithatë, zbulimi i kallëpeve për prerjen e monedhave lë të hamendësohet se qyteti i Ulpianës, mbase, edhe mund ta kishte gëzuar privilegjin e së drejtës së prerjes së monedhave. Në këtë kontekst, një rast të veçantë paraqet kallëpi i plumbit i perandorit Mark Aurel,⁵ i zbuluar gjatë gërmimeve arkeologjike të zhvilluara në vitin 1957, i cili sot ruhet në Muzeun Kombëtar të Kosovës.⁶ Ka formë rrethore dhe është i punuar nga plumbi. Kallëpi është i ruajtur relativisht mirë dhe ka dimensione: gjerësia 8.2 cm, trashësia 0.7 cm, perimetri 79.4 mm, kurse diametri i monedhës është R = 25.3 mm. Portreti i perandorit është i ruajtur mirë dhe në të mund të dallohen të gjitha detajet: flokët, mjekra, tiparet e fytyrës, veshja e tij si dhe legjenda që qarkon portretin. Gjurmët e pikave (grénétis) që qarkojnë monedhën janë

2 Lidhur me qarkullimin monetar në Ulpianë shih: Arben Hajdari, *Ulpiana et la romanisation de la Dardani*, tezë doktorate, Grenoble, 2013, 109-134.

3 Arben Hajdari, *Ulpiana et la romanisation de la Dardani...*, 132-134.

4 Për më shumë lidhur me këtë shih: Oliver Davies, *Roman Mining in Europe*, Oxford, 1935. 196; V. Simić dhe M.R. Vasić, 1977, "La monnaies des mines romaines de l'Illyrie", *RN* 19, 48-60.

5 Falënderoj Charles Parisot-Sillon, profesor në Universitetin e Orléans (CNRS-Univ. Orléans), për sugjerimet e dhëna, në lidhje me falsifikimin e monedhave në periudhën romake.

6 Kallëpi nuk figuron në listën e inventarit të Muzeut të Kosovës, por ai figuron në listën e inventarit të terrenit të vitit 1957 me numrin 227. Shih: Terenski inventar nadjeni na Ulpiana u 1957 godine, Arkivi i Muzeut Kombëtar të Kosovës.

të paplota. Nëse vëzhgohet dhe analizohet me kujdes pjesa përgjatë bordurës që paraqiste skajet e monedhës, ka të ngjarë se ato nuk kanë qenë fare të gdhendura në kallëp. Bordura e kallëpit është e ruajtur mirë, përjashtimisht pjesës mbi kokë, që është e dëmtuar pjesërisht.

Gjykuar nga të dhënat që janë ruajtur në të, mund të konkludohet se, fjala është për një kallëp të përparmë, i punuar shumë mirë artistikisht, i cili përfaqëson profilin e perandorit Mark Aurel me mjekër, pa kurorë, drape, të kthyer djathtas. Në të lexohet legjenda AVRELIUS CAESAR AVG. P. II F (Aurelius Caesar, Augusti Pii Filius) dhe përfaqëson një monedhë, në anën e pasme të së cilës, me shumë gjasë, ishte legjenda TR POT III COS II (Tribunicia Potestate Tertia, Consul Secundum). Në bazë të paraqitjes figurative të perandorit, ku është pa kurorë dhe mbishkrimit të kallëpit, shihet se kjo monedhë është prerë në kohën sa ai ishte caesar august, duke na ofruar kështu një *terminus post quem* fillestar, të përafërt, për kohën emetimit të saj.

Mungesa e shtyllës që shërbente për derdhje të metalit, sugjeron se kallëpi nuk shërbente për prerje të monedhave me derdhje direkte. Në anën tjetër, duke qenë nga materiali i plumbit, i cili pikën e shkrirjes e ka dukshëm me të ulët se sa bakri apo argjendi, e bën atë një kallëp jo fort të zakonshëm për prerjen e monedhave. Prandaj, me shumë gjasë, fjala është për një matricë të përdorur në një fazë të ndërmjetme gjatë procesit të prodhimit të një kallëpi falsifikues ose një disk monetar.⁷

⁷ Studimet numizmatike në këtë fushë mbeten ende të kufizuara. Lidhur me këtë shih: Louis-Pol Delestrée dhe Jean-Luc Buathier, “Les disques monétaires gaulois du Massif des Bauges “Savoie”, Société d’Études Numismatiques et Archéologiques, 2007, 3-26; Louis-Pol Delestrée, “La problématique des ateliers monétaires gaulois”, Cercle d’études numismatiques - European Centre for Numismatic Studies, Bruxelles, 2020, 65-78.

Foto 1. Kallëpi i monedhave nga Ulpiana.⁸

Nuk ka dyshim se ky kallëp është përdorur aty ku është gjetur. Në anën tjetër seritë që prezantojnë këto lloje të monedhave, emetohen dhe lëshohen ekskluzivisht nga punishtet e Romës duke sugjeruar kështu se ky kallëp nuk shërbente për prerje monetare zyrtare. Si i tillë ai duhet të jetë përdorur për të prodhuar emesione të falsifikuara. Për më tepër, kallëpi nuk ngjanë me kallëpet e zakonshëm monetarë të kësaj periudhe, sikundër që gjurmët e pikave (grénétis) që rrethojnë legjendën dhe portretin nuk janë të plota edhe pse mund të dallohen qartë skajet e bordurës së monedhës, duke konfirmuar kështu se kemi të bëjmë me një mjet falsifikimi. Pyetja shtrohet se çfarë tipi të monedhave mund të jenë falsifikuar? Zakonisht falsifikoheshin monedha me vlera të larta si *aureus* apo *denarius*. Të dhënat që na ofron kallëpi, lënë të kuptohet se monedha që mund të jetë emetuar nga ky kallëp i përgjigjet tipave të monedhave, *aureus* apo *denarius*, të tipit *RIC III*, Ant.

⁸ Foto e realizuar nga Emine Hajdari, në Muzeun Kombëtar të Kosovës. Monumenti ndodhet i ekspozuar në ekspozitën bazë, pavijoni i arkeologjisë.

479d,⁹ duke na ofruar një terminus *post quem* rreth viteve 158/159 pas Kr. Megjithatë diametri i monedhës së emetuar në kallëp, nuk i përgjigjet këtyre tipave të monedhave, duke përjashtuar mundësinë e emetimit të tyre përmes këtij kallëpi. Përmasat e kallëpit i përgjigjen më shumë tipave të monedhave të prodhuara nga metale të tjera të llojit *ACE* ose *dupondius*. Falsifikimi i këtyre monedhave ishte më i pazakontë, për faktin se apriori, ishte shumë me fitimprurës falsifikimi i monedhave prej ari dhe argjendi se sa i atyre prej bakri apo bronzi. Një fakt i tillë e bënë shumë më të pazakontë prezencën e këtij kallëpi në Ulpianë.

Në koleksionin numizmatik të Muzeut Kombëtar të Kosovës, ruhet një monedhë prej bronzi e tipit *dupondius*¹⁰ e perandorit Mark Aurel. Në të shfaqet perandori i ri me mjekër, pa kurorë, i kthyer majtas. Kurse monedha mban legjendën AVRELIUS CAESAR AVG. P. II F. Në shpinën e saj kemi të paraqitur Pietas, e cila qëndron në këmbë, e kthyer në të majtë, para saj qëndron një fëmijë. Në të lexojmë PIETAS (në segment) S C, TR POT III COS II.¹¹ Monedha ka peshë prej 9.66 gramë dhe diametër R = 29 mm, dhe koha e emetimit të saj është 148/149 pas Kr. Faqja e kësaj monedhe i përgjigjet tipit të monedhës së emetuar nga ky kallëp. Edhe përkundër ngjashmërisë, diametri i monedhës së kallëpit është për 3.7 mm më i vogël se sa monedha e zbuluar në Ulpianë,¹² prandaj është e vështirë të thuhet që kjo monedhë ishte prerë në këtë kallëp.

Duke qenë se kallëpi nuk ngjanë me kallëpet e zakonshëm monetarë të kësaj periudhe, identifikimi i llojit të saktë të monedhës së emetuar me modelet në *RIC* nuk është i qartë. Megjithatë, mund të thuhet se si terminus *post quem* të fillimit të prerjes së kësaj monedhe duhet të jenë vitet 149-159 pas Kr.

Fakti që Ulpiana ishte një qendër e rëndësishme metalurgjike e vendosur në një rajon të pasur me minerale të shumta, prej tyre ari dhe argjendi, sugjeron se kallëpi i zbuluar në Ulpianë shërbente për të realizuar emetime të paligjshme. *Adulteratores monetae*, në Mezinë Superiore dhe

⁹ *Roman Imperial Coinage*, III, 479d, 90.

¹⁰ Dosja Ulpiana - nr. inv. 4, Arkivi i Muzeut Kombëtar të Kosovës.

¹¹ *RIC III*, Ant. nr. 1294a.

¹² Dimensionet janë marrë sipas të dhënave që janë pasqyruar në kartelën e monedhës. Ishte e pamundur që dimensionet të verifikohen për faktin se Muzeu është në proces të rinovimit të depove dhe të trajtimit të koleksioneve.

provinca të tjera fqinje, ishin shumë aktivë. Ata prodhonin kryesisht denarë argjendi, të paligjshëm, e cila ishte monedha më e përdorur dhe me vlerë të konsiderueshme për shkak të peshës së metalit të çmuar.¹³ Mbi aktivitetet e tyre ilegale në provincën e Mezisë, në shekullin II, na dëshmon edhe juristi romak Saturninus.¹⁴ Prandaj, prania e *adulteratores monetae* në Ulpianë, në një nga qendrat e rëndësishme të administrimit të minierave në provincën e Mezisë, është krejtësisht i mundshëm dhe aspak nuk është befasues. Kësisoj, kallëpi i zbuluar në Ulpianë, bazuar në vlerën e monedhave, me shumë gjasë shërbente për të emetuar *denarius* të paligjshëm sesa ndonjë monedhë tjetër me vlerë të vogël. Mospërputhjen me standardet e monedhave zyrtare që emetoheshin, pos faktit se ishte një kallëp i falsifikuar, atë duhet parë më shumë në kontekst të asaj se kallëpi shërbente më shumë si një matricë në një fazë të ndërmjetme të përgatitjes së kallëpeve për falsifikim të këtyre monedhave.

13 Slobodan Dušanić, “Kovanje noca u rudničkim distriktima rimskog Ilirika”, *Silver workshops and Mints*, Beograd 1995, 131-146.

14 Saturninus, Dig.48.19.16.9 l.S. de poen. paganorum. “*Evenit, ut eadem scelera in quibusdam provinciis gravius plectantur, ut in Africa messium incensores, in Mysia vitium, ubi metalla sunt adulteratores monetae.*”

Emine HAJDARI

SUMMARY

ILLEGAL COINS MINTING IN DARDANIA: THE CASE OF THE MOLD FROM THE MUNICIPALITY OF ULPIANA

During the 1957 archaeological excavations at the Ulpiana site, a lead mold was uncovered, which is now housed in the National Museum of Kosovo. This mold, used for minting coins during the reign of Emperor Marcus Aurelius, is circular in shape and crafted from lead. It remains relatively well-preserved, with the following dimensions: a width of 8.2 cm, a thickness of 0.7 cm, and a perimeter of 79.4 mm. The mold was designed to produce coins with a diameter of 25.3 mm. Based on the preserved details, it can be concluded that this is a front mold, skillfully crafted, depicting the profile of Emperor Marcus Aurelius. The emperor is shown with a beard, without a crown, draped, and facing right. The inscription on the mold reads "AVRELIUS CAESAR AVG. P. II F." The mold likely represents the obverse of a coin, with the reverse most probably featuring the inscription "TR POT III COS II."

There is no doubt that this die was used at the location where it was discovered. However, the series of coins featuring this design were issued and minted exclusively by Roman mints, which suggests that this die was not employed for official coinage. Therefore, it is likely that it was used to produce counterfeit coins. The fact that Ulpiana was a significant metallurgical center situated in a region rich in various minerals, including gold and silver, suggests that the mold discovered there was likely used for illicit coin production. The *adulteratores monetae*, active in Moesia Superiore and other neighboring provinces, were notorious for their illegal minting activities. They primarily produced counterfeit silver denarii, the most commonly used and valuable coin due to its precious metal content. The Roman jurist Saturninus also attests to the widespread illegal coinage activities in the province of Moesia during the 2nd century.